

PKR.469/14

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA, si gjykatë e shkallës së parë penale, kryetarja e trupit gjykues, gjyqtarja Suzana Çerkini, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Ardita Azemi, në çështjen penale kundër të akuzuarit N.A., nga fshati B. Komuna P., për shkak të veprave penale, Mbajtja, në pronësi, kontroll, ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPRK, dhe veprës penale Shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm nga neni 365 par. 3 lidhur me par. 1 të KPRK, i akuzuar sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë, Departamenti për Krime të Rënda PP.I.nr.820/2013, të datës 08.09.2014, pas shqyrtimit fillestar, të hapur për publikun, të mbajtur më datë 05.08.2016, me praninë e Prokurorit të shtetit Feti Tunizliu dhe të akuzuarit N.A., me datë 08.08.2016, mori dhe shpalli publikisht këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri N.A., i biri i S. dhe nënës N., e vajzërisë Ç., i lindur me *data e lindjes...*, në fshatin B. Komuna P. ku edhe jeton, ka të kryer shkollën fillore me profesion bujk, i martuar babë i nëntë fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike, Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i identifikuar me LNJ të RKS me nr. personal *numër personal...*,

Ë S H T Ë F A J T O R

I. Sepse, nga data e pa caktuar e deri më datën 01.09.2013, rreth orës 11:00, në shtëpinë e tij në fshatin B. Komuna P., ka poseduar në shkelje me ligjin e zbatueshëm lidhur me armët e tilla, pushkën automatike të kalibrit 7.62 mm, me nr. serik 367431 me bajonet dhe katër gëzhoja cal.7.62 mm, si dhe pistoletën me gaz të tipit Ecol Mod. 2005, me nr. serik AC-611001-Ans Compact me karikator dhe dy gëzhoja, të cilat i janë konfiskuar nga ana e policisë,-

- me çka ka kryer veprë penale Mbajtja, në pronësi, kontroll, ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPRK,

II. Me datën, kohën dhe vendin e përshkruar si në dispozitivin e parë, i pandehuri N.A., në vendin ku kanë qenë të pranishëm një numër i madh i njerëzve, ka shkaktuar rrezik të madh për jetën e tyre, në atë mënyrë që me rastin e fejesës së dy djemve të tij, me armën-pushkën automatike të kalibrit 7.62 mm, me nr. serik 367431, ka shtënë disa herë,-

- me çka ka kryer veprën penale Shkaktim i rrezikut të përgjithshëm nga neni 365 par. 3 lidhur me par. 1 të KPRK,

Andaj, gjykata, në bazë të nenit 7, 17, 21, 41,42, 46, 49,50,51,52,53,73 të KPRK dhe nenit 248, 365 dhe 366 të KPP, i shqipton,

DËNIM ME KUSHT

Për veprën penale nga **pika I e dispozitivit**, në kohëzgjatje prej **1 (një) viti** i cili nuk do të ekzekutohet, nëse brenda afatit prej **2 (dy) vitesh** nuk do të kryejë veprën të re penale dhe,

DËNIM ME GJOBË

Për veprën penale nga **pika II e dispozitivit**, në shumë prej **300 € (treqind euro)**,

Komfor nenit 80 par.2 pika 2.5 të KPP, të akuzuarit i shqipton:

DËNIM UNIK ME KUSHT DHE ME GJOBË

Në kohëzgjatje prej **1 (një) viti** i cili nuk do të ekzekutohet, nëse brenda afatit prej **2 (dy) vitesh** nuk do të kryejë veprën të re penale dhe dënim me gjobë në shumë prej **250 € (dyqindepesëdhjetë euro)**, të cilin dënim obligohet t'a paguajë brenda afatit prej 15 ditësh, pasi ky aktgjykim të merr formën e prerë,

Nëse dënimi me gjobë nuk mund të realizohet komfor nenit 46 të KPRK, gjykata këtë dënim me gjobë do t'ia shëndrrojë në dënim me burg duke llogaritur 20 euro për një ditë burgim,

Komfor nenit **62** nënpar.2.6 , 69 të KPRK, të akuzuarit gjithashtu i shqiton:

DËNIM PLOTËSUES

Konfiskohen: një revole me gaz “Ekol Mod” 2005 Aras Compact me nr. serik AC 611001, një karikator i revoles, dy gëzhoja të revoles me gas, një pushkë gjysmë automatike 367 431, si dhe katër gëzhoja të pushkës gjysmë automatike, të precizuara në vërtetimin e bashkangjitur në shkresa të lëndës, mbi marrjen e përkohshme të sendeve Nr.2013-AF-1292, të datës 01.09.2013, si mjete të kryerjes së veprave penale,

I akuzuari obligohet t’i paguajë shpenzimet e procedurës penale aq sa do të bëhen sipas llogarisë së gjykatës, ndërsa në emër të paushallit gjyqësor do të paguajë shumën prej 30 € (tridhjetë) euro, në afat prej 15 ditësh, pasi ky aktgjykim të merr formën e prerë,

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë, me Aktakuzën PP.I.nr.820/2013, të datës 08.09.2014, ka akuzuar N.A.n, nga fshati B. Komuna P., për shkak të veprave penale, Mbajtja, në pronësi, kontroll, ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPRK, dhe veprës penale Shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm nga neni 365 par. 3 lidhur me par. 1 të KPRK dhe, njëherësh i ka propozuar gjykatës që pas administrimit të provave në shqyrtim gjyqësor, të akuzuarin t’a shpall fajtor dhe t’a dënojë sipas ligjit.

Gjykata duke vepruar në këtë çështje penale sipas aktakuzës së lartshënuar, mbajti shqyrtim fillestar me datë 05.08.2016, në të cilin i pandehuri N.A., i vënë nga gjykata në dijeni të plotë për natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, vullnetarisht pranoi në tërësi fajësinë për veprat penale që i vihen në barrë, theksoi se është e vërtetë se ka gjuajtur me rastin e fejesës së dy djemve të tij, është larguar 20 metra larg objektit ku ishin të tubuar rreth 150 burra, ka shtënë me dy armët në drejtim të tokës me pamje nga nuk ka vendbanim, i njëjti ka shprehur keqardhje për atë që ka ndodhur por asnjëherë tjetër nuk e ka përsëritur këtë veprim dhe, në fund kërkoi nga gjykata t’i shqiptojë një dënim sa më të butë.

Prokurori i shtetit gjithashtu shprehu pajtimin për pranimin e fajësisë nga i pandehuri, për dy veprat penale, andaj i ka propozuar gjykatës që të njëjtin ta shpall fajtor dhe ta dënoj sipas ligjit, gjithashtu i ka propozuar gjykatës që me rastin e matjes së dënimit të merr parasysh rrethanat lehtësuese, se

më parë nuk ka qenë i gjykuar, se e ka pranuar fajësinë, faktin se është baba i nëntë fëmijëve, se është penduar për veprën e kryer dhe shpreh keqardhje për këtë, në fund i ka propozuar gjykatës që dënimi të jetë në proporcion me shkallën e përgjegjësisë penale të tij si dhe intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të këtyre veprave penale që të arrihet qëllimi i dënimit

Pas deklarimit të të pandehurit për pranimin e fajësisë dhe pas pajtimit të prokurorit për pranimin e fajësisë nga i pandehuri, gjykata gjithashtu e aprovoi pranimin e fajësisë nga i pandehuri, pasi është bindur se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, dhe se ky pranim është bërë vullnetarisht dhe i mbështetur në faktet e çështjes që përmbanë aktakuza.

Gjykata, pas aprovimit të fajësisë së të pandehurit dhe vlerësimit të rrethanave të rastit, konstatoi gjendjen e fakteve që e përmban akuza, nxjerri konkluzion të drejtë dhe të ligjshëm, se në veprimet e të pandehurit, ekzistojnë elementet e veprave penale që i vihen në barrë, të përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, andaj pasi që më parë gjeti se i pandehuri është penalisht përgjegjës, të njëjtin e shpalli fajtor për veprën penale Mbajtja, në pronësi, kontroll, ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPRK, dhe veprën penale Shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm nga neni 365 par. 3 lidhur me par. 1 të KPRK dhe, i shqiptoi dënimin e paraparë ligjor.

Me rastin e përcaktimit të vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit të lartshënuar, gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat e parapara ligjore që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, si, rrethanat lehtësuese: pranimin e fajësisë, pendimin e shprehur për veprën e kryer, premtimin e dhënë se nuk do t'a përsërisë veprën penale, paraqitjen korrekte në gjykatë, gjendjen e rëndë ekonomike ndërsa rrethanë rënduese nuk gjeti, andaj të njëjtit i shqiptoi dënim unik, burgim të cilin ia kushtëzoi për periudhë të caktuar verifikuese, si dhe dënim me gjobë, të precizuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me bindje se dënimi i tillë i përgjigjet peshës së veprës penale, sjelljeve dhe shkallës së përgjegjësisë penale të të pandehurit, se ky dënim do të ndikojë në resocializimin e të njëjtit, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, gjithashtu, do të ndikojë tek të tjerët në mos kryerjen e veprave penale dhe se, me dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 41 të KPRK dhe në fund, me bindje se i pandehuri në të ardhmen nuk do të përsërisë vepër tjetër penale të natyrës së tillë apo të ngjashme.

Vendimin për konfiskimin e sendeve, të armëve dhe gjësendeve të tjera të përdorura në mënyrë të paautorizuar, të precizuara në listën e provave të datës 01.09.2013, gjykata e ka marrë në bazë të nenit 69 të KPRK lidhur me nenin 374 par.3 të KPRK si dhe nenit 115 par.2 pika 2.2 të KPP.

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor, gjykata e mori në bazë të nenit 450 par.2 pika 2.6 lidhur me nenin 453 par. 1 të KPP.

Nga sa u tha më lartë, dhe në bazë të nenit 365 të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË/DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA
PKR.469/14, me datë 08.08.2016**

**Sekretarja juridike
Ardita Azemi**

**Kryetarja e trupit gjykues-gjyqtarja,
Suzana Çerkini**

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi, ankesë mund të paraqesin personat e autorizuar brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit. Ankesa bëhet përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.